

SHQIPËRI ITALI



vs



vs



AIR ALBANIA STADIUM

16 NËNTOR 2022, ORA 20:45



From grassroots to Heroes

for every athlete at every level

Come and discover more at

macron STORE

TIRANA: Ring Center Tirana
Zogu i zi, Albania
T: +35 56 82 00 67 47
tirana@macronstore.com

Find the Macron Store
closest to you



These clubs have chosen Macron



macron.com



www.fshf.org

FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT



3



TË DASHUR MIQ TË FUTBOLLIT!

Po i drejtohem fundit të edicionit kuqezi dhe vitit kalendarik me dy duele mjaft të bukura për Kombëtaren shqiptare e që sigurojnë një festë të vërtetë për të gjithë tifozët. Me dy ndeshje miqësore të nivelit të lartë që luhen në fushën tonë pak ditë para nisjes së finaleve të Botërorit “Katar 2022”.

Në Tiranë më 16 nëntor vjen Italia, kampionia e Europës, në një miqësore luksi. Ndonëse të kaltrit nuk mundën të kualifikoheshin, më shumë të dënuar nga fati i keq, për në finalen e Botërorit “Katar 2022”, kanë një skuadër të madhe me plot yje dhe talente. Në stadiumin e kryeqytetit do të zbarkojnë lojtarët më me emër në vendin fqinj, të cilët shumë tifozë shqiptarë i adhurojnë dhe i ndjekin çdo javë nga ekrani me klubet e Serie A.

Në fakt, nuk është rastësi që italianët pranuan një kundërshtar të fortë për të testuar si duhet ekipin dhe kombëtarja kuqezi i plotëson kushtet për të ofruar një ndeshje mes të barabartëve.

Pavarësisht se rezultatet e fundit nuk kanë qenë pozitive, të ndikuara dhe nga mungesat e shumta dhe problemet me dëmtimet në çdo ndeshje, kombëtarja u ka treguar të gjithëve se është rritur dhe tashmë ka hyrë në mesin e skuadrave më të mira të Europës. Pak muaj më parë ne luajtëm një miqësore edhe me Spanjën, ish-kampionen e Botës dhe e Europës dhe padyshim një nga gjigandët e futbollit. Një tjetër konfirmim se tashmë kemi hyrë në klubin e më të mëdhenjve dhe kemi shansin të luajmë me kombëtare që kanë bërë historinë e futbollit.

Jo më kot renditemi në vendin e 27-të të UEFA-s, ndërkohë që ishim shumë pranë ëndrrës së madhe për t'u kualifikuar në fazën play-off të Botërorit 2022, duke iu afruar më shumë se kurrë më parë në historinë tonë dhe duke humbur garën vetëm në metrat e fundit ndaj Polonisë. Rritja ka qenë graduale, por e qëndrueshme dhe e dukshme, pasi skuadra luan mirë si brenda ashtu edhe jashtë fushe dhe ka në gjirin e saj lojtarë të rinj e të talentuar, që premtojnë një të ardhme të shkëlqyer përpara. Me Italinë është një mundësi shumë e mirë për të konfirmuar rritjen, për të parë se ku kemi arritur

dhe ku duhet të përmirësohemi për të qenë edhe më të mirë në të ardhmen.

Nuk është më pak e rëndësishme as miqësorja me Armeninë, që luhet po në “Air Albania” më datë 19 nëntor. Një kundërshtar shumë i fortë e që do të ofrojë një përballje të nivelit të lartë, e gjitha për t'u jetuar me emocione në 90 minuta si nga lojtarët në fushë ashtu edhe nga spektatorët në shkallët e stadiumit. Uroj që tifozët të jenë të shumtë të numër dhe t'i shijojnë “live” në stadium këto përballje emocionuese. Jam i bindur që Kombëtarja jonë do të japë maksimumin dhe do të luftojë deri në fund për të marrë rezultate pozitive në të dyja sfidat. Vërtetë rezultatet nuk kanë qenë ato që të gjithë prisnin gjatë këtij viti, por djemtë kanë dhënë maksimumin në fushë dhe në shumë raste nuk i kanë merituar të humbin apo të barazonin.

Përtej aspektit sportiv dhe spektaklit, këto dy ndeshje shënojnë edhe startin e edicionit të ri, që zyrtarisht do të nisë me eliminatorët e “Euro 2024” në muajin mars. Koha në dispozicion nuk është shumë dhe për këtë arsye përgatitjet nisin që tani dhe për këtë arsye këto dy miqësore marrin vlera shumë të mëdha dhe shënojnë testin e parë të rëndësishëm për të kolauduar ekipin gradualisht e për të qenë gati për ndeshjet zyrtare. Për të qenë gati për të përmbushur misionin e madh, që është kualifikimi për në finalen e Euro 2024.

Një objektiv që nuk mund të quhet aspak utopik e që mund të arrihet nëse të gjithë do të japim maksimumin dhe do ta mbështesim Kombëtaren në çdo hap. Një objektiv real, që do të shënonte një arritje historike për të dytën herë pas finaleve të Euro “Francë 2016”. Por nuk duhet kurrësi ta marrim lehtë, sepse jemi të ndërgjegjshëm se kjo mund të arrihet me shumë punë, mund, djersë e sakrificë të mëdha. Kam shumë besim te kjo skuadër dhe uroj shumë që ta nisim këtë aventurë me rezultate pozitive në këto miqësore e të përgatitemi me qetësi për sfidat e marsit.

U uroj sa më shumë suksese djemve kuqezi dhe Kombëtares shqiptare në këto miqësore, por edhe ne sfidat e ardhshme.

Miqësisht,
Armand Duka

Porosite online në:
www.shop.amacaffe.com

 **UNIONBANK**

#gjithmonëmeKompëtaren

Compatible to Nespresso® machine

 unionbank.al  +355 4 238 9111

Kapsulat janë të përshtatshme për çdo aparat ekspresi Nespresso®

E gjeni në:

 ama
boutique

 eco

 SPAR



MIQËSORET E NËNTORIT

“NXEMJA” E FUNDIT E KUQEZINJVE PARA NISJES SË MISIIONIT TË MADH EURO 2024

Kombëtarja shqiptare do të përfundojë këtë fundjavë një “tur force” të nisur që në fund të muajit tetor me katër miqësore, si kurrë më parë. Një kalendar i imponuar ndjeshëm edhe nga finaliteti e Botërorit “Katar 2022”, që nis më datë 20 nëntor dhe që ka ndryshuar tërësisht sezonin tradicional të futbollit, veçanërisht në të gjithë kontinentin evropian, dhe jo vetëm. Një prolog apo “nxemje” që mund të japë shumë përgjigje, konfirmime apo risi të rëndësishme në kuadër të përgatitjeve të Shqipërisë për misionin e radhës që nis në muajin mars, eliminatoret e Euro 2024. Pikërisht aty ku synojmë të arrijmë për të fiksuar pjesëmarrjen e dytë historike në finalitetin e një turneu madhor, pas Euro “Francë 2016”.

Kuqezinjtë zhvilluan një miqësore me Arabinë Saudite në Abu Dabi më 26 tetor me ndeshjen që përfundoi në barazim 1-1, por stafi teknik pati mundësinë të provonte shumë lojtarë të rinj e të spikatur nga kampionati shqiptar “Abissnet Superiore”, por edhe disa nga “garda vjetër” të cilët arritën të merrnin leje nga klubet për këtë ndeshje jashtë kalendarit zyrtar të FIFA-s. Përtej rezultatit test ndaj një prej skuadrave pjesëmarrëse në finalitetin e Botërorit 2022 ishte mjaft i vlefshëm për trajnerin Edy Reja që arriti të shohë në aksion në një ndeshje të vërtetë shumë elementë që mund do të kenë shansin për të veshur fanellën kuqezi në të ardhmen. Ndonëse me shumë ndryshime ekipi bëri një paraqitje mjaft pozitive, duke sfiduar të

”

**Misioni nis që tani,
nga këto dy miqësore që
ofrojnë prestigj, futboll
cilësor, por ku do të luhet
edhe për rezultate pozitive,
që natyrshëm do t'i jepnin
një motiv krenarie dhe
stimuj mjaft të vlefshëm
skuadrës dhe tifozëve**

gjitha pritshmëritë për shkak të kohës së pakët në dispozicion.

Përgjigjet e para u morën, ndërsa FSHF rriti akordin me një tjetër finaliste të Botërorit për një miqësore, pikërisht me Katarin, vendin mikpritës të turneut më të rëndësishëm të futbollit në planet. Ndeshja këtë herë u zhvillua në Marbella të Spanjës, me stafin teknik që ftoi sërish shumë lojtarë të klubeve shqiptare dhe munguan “legjionarët”. Sërish paraqitja ishte pozitive, ndonëse Katar fitoi 1-0 me një penallti, por kuqezinjtë krijuan shumë raste për gol, volum loje dhe meritoni më shumë po të mos ishte për vendimet e gjyqtarit që lanë për të dëshiruar. Jo më kot në fund të miqësorës tekniku foli me nota pozitive për ekipin dhe theksoi se janë të paktën 4-5 lojtarë që do të mbahen në vëzhgim dhe janë kandidatë potencial për t'u bërë pjesë e Kombëtares.

Etapa e fundit e “nxemjes” janë pikërisht dy miqësoret e fundit të nëntorit. Këtë herë situata është disi ndryshe, pasi në dispozicion të stafit teknik do të jenë shumë nga lojtarët e ekipit bazë të cilët kanë qenë pjesë e rregullt e Kombëtares gjatë edicionit të fundit të Nations League dhe në eliminatoret e Botërorit “Katar 2022”. Sigurisht ka shumë të rinj, që vijnë me ambicie të mëdha të gatshëm për t'u bërë pjesë e procesit të vazhdueshëm të rinovimit e që synojnë formacionin përmes “bëmave” dhe talentit në fushën e lojës.

Prova e parë është me Italinë, kampionen në fuqi të Europës, që vjen në Tiranë me lojtarët më të mirë të momentit dhe me disa të rinj të talentuar



që kanë një perspektivë të shkëlqyera përpara. Një ndeshje prestigji e gjitha për t'u shijuar e që ofron stimuj pa fund për lojtarët kuqezi, të etur për t'i treguar njërës prej kombëtareve më të mira në botë se janë në gjendje të përballen si të barabartë me këdo. Një vitrinë e shkëlqyer për Shqipërinë e futbollit dhe një test me shumë rëndësi në prag të eliminatoreve të Euro 2024.

Pikërisht një përballje nga ato që i duhen shumë Shqipërisë për t'u matur me më të mëdhatë dhe për të kuptuar progresin dhe nivelin ku kemi arritur. Një miqësore me shumë vlera në të gjitha dimensionet, për të rinjtë, për stafin teknik, për aspektin teknik të ekipit, por edhe për tifozët që do të mund të shijojnë një ndeshje yjesh në mes të Tiranës dhe futbollit elitari. Janë pikërisht këto sfida që nevojiten për të kolauduar ekipin në prag të objektivave të mëdhenj.

E jo më pak vlen edhe miqësoria e dytë me Armeninë, ajo që luhet më 19 nëntor po në “Air Albania” e që do të ofrojë një përballje me një skuadër të cilës nuk i mungojnë yjet dhe eksperiencia për të dhuruar një ndeshje të nivelit të lartë. Shans i shkëlqyer për shumë të rinj që të tregojnë aftësitë dhe për ekipin që të vërtetojë rritjen dhe të “ligjërojë” objektivat e mëdha kuqezi. E kjo miqësore do të mbyllë një vit me plot emocione për Kombëtaren, me ulje-ngritjet e veta në rezultate, por që do të shënojë në fakt prologun e një edicioni të ri e do të shtrojë rrugën për të përgatitur sa më mirë eliminatoret e “Euro 2024”.

Me objektivin e shpallur tashmë për të arritur në fazën finale të turneut më të madh kontinental, jo thjesht si një dëshirë e një populli apo e FSHF-së, por si një shënjestër reale e që mund të arrihet nga kjo gjeneratë, duke parë talentin dhe aftësitë e tyre, por duke punuar me shumë sakrificë me kokën ulur, me qëndrimin maksimal në fushë dhe jashtë saj, duke qëndruar të bashkuar për të bërë realitet ëndrrën e një kombi të tërë, që jeton me futbollin dhe që e do shumë këtë sport. Dhe misioni në fakt nis që tani, nga këto dy miqësore që ofrojnë prestigj, futboll cilësor, por ku do të luhet edhe për rezultate pozitive, që natyrshëm do t'i jepnin një motiv krenarie dhe stimuj mjaft të vlefshëm skuadrës dhe tifozëve.



STAFI TEKNIK I KOMBËTARES A



EDY REJA
TRAJNER

FEDERATA
SHQIPTARE E
FUTBOLLIT



SERGIO PORRINI
ZV.TRAJNER



ERVIN BULKU
ZV.TRAJNER



HAMDI SALIHI
ZV.TRAJNER



ILIR BOZHIQI
TRAJNER PORTIERESH



LUIGI FEBBRARI
PERGATITES ATLETIK



LUCA LAURENTI
ZV.PERGATITES ATLETIK



ALARICO ROSSI
VIDEOANALIST



DRITAN BABAMUSTA
MANAXHER I EKIT



GIANLUCA STESINA
DOKTOR



ILVI BEGOLLI
FIZIOTERAPIST



ARZEN VOCI
FIZIOTERAPIST



FATOS KADEMI
KIT MANAGER

PROFIL

EDY REJA



Më 9 nëntor të këtij viti, ndaj Katarit, italiani Edy Reja u ul për të 36-tën herë në stolin e Kombëtares shqiptare. Tekniku i njohur, i lindur në shtetin fqinj të Italisë më 10 tetor të vitit 1945, Edoardo Reja, ka qenë futbollist i shumë klubeve italiane dhe më pas drejtues i disa prej ekipeve më me emër në Itali dhe në Europë, teksa prej më shumë se tre vitesh drejton Shqipërinë.

Karrierën si trajner e nisi 41 vite më parë, kur mori drejtimin e klubit të Molinelës, një ekipi të vogël italian, ndërsa më pas iu besuan edhe pankinat e skuadrave të tjera italiane si Atalanta, Lazio, Bologna, Torino, Genoa, Cagliari, etj.

Kulmin e karrierës së tij e pati teksa drejtoi ekipin e Napolit. Edhe pse në krye të një ekipi Kombëtar tashmë, ende Reja shihet me adhurim nga napoletanët, të cilët e admirojnë për punën e bërë në krye të klubit.

POR KUSH ËSHTË REJA I SHQIPËRISË?

Pas largimit të ish-trajnerit të ekipit Kombëtar, Christian Panuçi, Federata Shqiptare e Futbollit kishte në tavolinë disa emra. Ndër to ishte edhe emri i italianit Edoardo Reja, të cilit, Federata i besoi pa hezitim pankinën e ekipit Kombëtar.

Edy Reja, njeriu i cili e gjeti Shqipërinë në një moment të vështirë, me një skuadër që e kishte humbur identitetin e 2016, vit kur Kombëtarja arriti suksesin më të madh, duke u kualifikuar në Europian, arriti të rikthejë atmosferën pozitive në skuadër. Komunikues dhe fjalëpak, i qetë dhe i zhurmshëm, strikt dhe liberal, inteligjent, Reja i ktheu optimizmin ekipit tonë Kombëtar.

Tekniku italian ka arritur disa rekorde me Shqipërinë.

Fillimisht, Reja e nisi me një humbje në Islandë, me Shqipërinë, që u mund minimalisht 1-0 në ndeshjen e vlefshme

për eliminatorët e Europeanit, por në ndeshjen e dytë u rikthye me një fitore 2-0 ndaj Moldavisë. Po në këtë grup Kombëtarja nën drejtimin e Edy Rejës korri edhe dy fitore me goleada, 4-2 ndaj Islandës në kthim dhe 4-0 ndaj Moldavisë. Fitore me të tilla shifra Shqipëria nuk kishte arritur më parë në ndeshje zyrtare. Por më i rëndësishëm është fakti se përfaqësuesja kuqezi me italianin në krye të stolit u rrit shumë si skuadër, qoftë në aspektin e lojës, qoftë në atë të rezultateve.

Një tjetër rekord shumë i rëndësishëm i arritur falë drejtimit të italianit Reja është Liga e Kombeve. Për herë të parë në historinë e futbollit shqiptar, Shqipëria ia doli të renditej e para e grupit 4 në Ligën C në këtë kompeticion europian, duke u ngjitur kështu në një ligë më të fortë, atë B.

Ndërkaq, edhe pse Kombëtarja shqiptare nuk arriti të ishte pjesë e finaleve të Botërorit 'Katar 2022', kualifikueset e këtij kompeticioni do të mbahen mend gjatë nga shqiptarët, për emocionet e dhuruara nga kuqezinjtë deri në ndeshjen e fundit. Si kurrë më parë, Shqipëria ia doli të grumbullonte 18 pikë në eliminatorët e një Botërori, me gjashtë ndeshje të fituara dhe katër të humbura. Kuqezinjtë siguruan edhe një fitore me 'shuplakë', duke mundur 5-0 San Marinon në 'Elbasan Arena', ndërsa kujtojmë edhe dy rezultatet pozitive të arritura kundër Hungarisë, në transfertë dhe në shtëpi.

Dhe e gjitha kjo, nën drejtimin e trajnerit italian, Edoardo Reja.

Për çdo pyetje, Edy Reja e ka gjithmonë një përgjigje, pasi në kokën e tij, çdo veprim do të ketë një pasojë që ai e ka menduar më parë. Strategjia dhe qetësia janë pikat e tij më të forta. Një trajner i tillë i ka dhënë shumë Shqipërisë, i ka dhënë shumë edhe shqiptarëve. Një trajner si Edy Reja duhet duartrokitur gjithmonë. Për emocionet që na ka sjellë dhe për arritjet e tij në krye të kësaj skuadre!



KAMPIONËT E BOTËS DHE EUROPËS ZBARKOJNË NË “AIR ALBANIA”

**ITALIA,
ËNDRRA E MADHE
E SHQIPTARËVE...
NË FUTBOLL!**

Emërkura e 16 nëntorit do të jetë pa dyshim një natë që do të mbahet mend gjatë. Futbollistët, tifozët dhe e gjithë Shqipëria do t'i kenë sytë nga ata, katër herë kampionët e botës dhe dy herë të Europës, të cilët do të zbarkojnë në stadiumin 'Air Albania' e do të luajnë kundër kuqezinjve tanë.

Është Italia, vendi ynë fqinj, që numëron me qindra-mijëra shqiptarë të vendosur ndër vite aty. Miqësore nuk mund të quhet kurrësi, më e saktë ndoshta do të jetë ta quajmë 'Vëllazërore', pasi lidhja që kemi me ta sot është shumë më shumë sesa thjesht fqinjë. Sot jemi... 'fratelli'.

Kur shqiptarët zbuluan futbollin në Shkodër, në vitin 1905, ishte njësoj si në Genua. Futbolli po përhapej si epidemi. Çdo gjë kishte një fillim dhe një fund. Për pak vite, deri në vitin 1930, u krijuan shumë shoqata, në çdo qytet të vendit. Italianët, që jetonin në Shqipëri, ndikuan që ky futboll të zhvillohej. Madje, edhe portieri i parë i Shqipërisë ka qenë një italian... i vetmi i huaj që ka luajtur për Shqipërinë.

Marrëdhëniet zyrtare mes dy shteteve kanë nisur në fakt që në vitin e largët 1912, kur Mbretëria e Italisë mbështeti Deklaratën e Pavarësisë më 1912. Gjatë periudhës së Monarkisë në Shqipëri, italianët ishin aleati ynë më i ngushtë, aq sa, gjuha italiane është mësuar si gjuhë e dytë në thuajse të gjitha shkollat në vendin tonë.

Mirëpo, historia nuk mund të zhbëhet dhe 7 prilli i vitit 1939, është shënuar në kalendar si data kur italianët mësynë në vendin tonë dhe Shqipëria u bë pjesë e Perandorisë Italiane. Por ajo çka ka ndodhur pas viteve 90' mes shqiptarëve dhe italianëve e sfumon historinë dhe ngjyrës së zezë fillon e i jep ngjyrat e jetës. Marrëdhëniet u shkëputën gjatë sundimit komunist në Shqipëri dhe gjatë kësaj periudhe, Italia është një prej skuadrave që nuk ka luajtur kurrë me Kombëtaren shqiptare. Ndërkohë, futbollit Italian ishte më i dashuri për shqiptarët, aq sa tifozët shqiptarë të 'axurrëve' në vendin tonë ishin thuajse në të njëjtin numër me ata të futbollit brazilian, gjerman, argjentinas e holandez.

Dhe shqiptarët 'fatkeqë' nuk patën kurrë mundësi të shihnin nga afër 'idhujt' e tyre, Cesare Maldini-n, Franco Baresi-n, Dino Zof, Roberto Baggio-n, Paolo Rossi-n, Roberto Donadoni-n, e shumë futbollistë të tjerë të mëdhenj të Kombëtares italiane. Tifozët e futbollit italian në vendin tonë, ata që kishin mundësi, i ndoqën vetëm përmes një ekrani bardhezi, ndonjëherë me 'miza',



e ndonjëherë tjetër, fare. Përveç vitit 1984, kur 'Shpresat' tona me Demollarin, Zmijanin, Jerën, Josën, etj., luajtën kundër Shpresave të Italisë së Mancinit (i cili sot vjen si trajner), Monelli-t etj., dhe u mundën me rezultatin minimal 0-1.

Kanë mbetur ndoshta shumë pak tifozë shqiptarë të Italisë, që ende kujtojnë me emocione tre vitet e arta, 1934, 1938 dhe 1982, vite kur Kombëtarja italiane është shpallur Kampione Bote në futboll, ndërsa me siguri të shumtë janë ata që i kujtojnë mirë vitet 1968 e sidomos 2021 (2020*), kur italianët u shpallën kampionë të Europës.

Kampionët e Botës dhe Europës nuk janë thjesht kampionë në futboll, por edhe në përgjegjësi sociale. E si thotë edhe një fjalë e urtë



Për të paktën një natë të vetme, shtëpia e shqiptarëve, 'Air Albania' do të ngjyrosset me tre ngjyra: të kuqe, të zezë dhe blu... sepse në stadiumin tonë kombëtar, do të luajnë ata, kampionët e botës dhe Europës

popullore, 'fshati që duket, nuk do kallauz', kjo merr shumë kuptim me italianët, që kanë mirëpritur në vendin e tyre mbi gjysmë milionë shqiptarë që pas viteve 90' e deri më sot. Madje, na përgjigjen ende.

Me Federatën Italiane të Futbollit, veç miqësorese së vitit 2014, ndeshja e parë në histori mes këtyre dy përfaqësuesve dhe ndeshjeve të vlefshme për Botërorin e vitit 2018, na ka bashkuar edhe solidariteti. Pas tërmetit të 26 nëntorit 2019 në Shqipëri, Federata Italiane e Futbollit i erdhi menjëherë në ndihmë Shqipërisë dhe bashkëpunoi me Federatën Shqiptare të Futbollit, duke ndihmuar në fondet e mbledhura për të ndërtuar shtëpitë e shkatërruara nga fatkeqësia natyrore. E kjo mori edhe më shumë vlerë, kur vetë Presidenti i Federatës Italiane të Futbollit erdhi në Shqipëri më 11 marsin e vitit 2021 për të inauguruar një prej këtyre shtëpive.

Tashmë, Presidenti Gabriele Gravina do të vijë sërish në Shqipëri, kësaj here jo më për të inaguruar një shtëpi, apo si i ftuar në Asamblenë Zgjedhore për President të FSHF-së, por për të ndjekur ekipin e tij të luajë në shtëpinë e shqiptarëve. Më 16 nëntor, në fushën e stadiumit 'Air Albania' do të vijë 'axurrët' e Roberto Mancini-t, të cilët janë as më pak e as më shumë, por kampionët aktualë të Europës.

Një ndeshje ku shqiptarët me siguri e kanë të vështirë të zgjedhin se cilin prej ekipeve do të mbështesin... e sidomos ata që jetojnë në Itali. Por, më e rëndësishme është atmosfera, që pa dyshim do të jetë elektrizuese. Dhe po kaq e sigurt është edhe se shqiptarët nuk do të vërsëllojnë në këndimin e himnit mik, por do ta këndojnë së bashku. Sepse për të paktën një natë të vetme, shtëpia e shqiptarëve, 'Air Albania' do të ngjyrosset me tre ngjyra: të kuqe, të zezë dhe blu... sepse në stadiumin tonë kombëtar, do të luajnë ata, kampionët e botës dhe Europës.



SHQIPËRIA



ELHAN KASTRATI



ETRIT BERISHA



GENTIAN SELMANI



MARASH KUMBULLA



ENEA MIHAJ



ENEO BITRI



ANDI HADROJ



ELSEID HYSAJ



ADRIAN BAJRAMI



ERDENIS GURISHTA



ARDIAN ISMAJLI



ERMIR LENJANI



ODISE ROSHI



AMIR ABRASHI



ENIS COKAJ



YLBER RAMADANI



ARB NOR MUCOLLI



QAZIM LAÇI



KRISTJAN ASLLANI



ERNEST MUCI



KEIDI BARE



NEDIM BAJRAMI



XHULIANO SKUKA



ARMANDO BROJA



MYRTO UZUNI



Full of Life
**ZGJIDH FORMATIN TËND
 TË PREFERUAR!**
 NGA RISITË E FUNDIT TË UJIT TEPELENE



www.ujitepelene.com



Për t'u ndjerë çdo ditë në formë



ITALIA




ALEX MERET



GIANLUIGI DONNARUMMA



GUGLIELMO VICARIO



PASQUALE MAZZOCCHI



LEONARDO BONUCCI



IVAN PROVEDEL



SAMUELE RICCI



MATTEO PESSINA



NICOLÒ ZANIOLO



SIMONE PAFUNDI



NICOLÒ FAGIOLI




SANDRO TONALI




MARCO VERRATTI




WILFRIED GNONTO



GIOVANNI DI LORENZO



NICOLÒ BARELLA



MATTEO POLITANO



FEDERICO DIMARCO



ALESSANDRO BASTONI



GIACOMO RASPADORI




FRANCESCO ACERBI



FEDERICO CHIESA



ANDREA PINAMONTI



VINCENZO GRIFO



GIOORGIO SCALVINI



FEDERICO GATTI



FABIO MIRETTI



FABIANO PARISI

Më mirë udhëtoni pa shqetësime

Asistencë
rrugore 24 orë
në gjithë
Europën.

**SIGAL UNIQA
AutoSOS**

Mbulimet që i duhen makinës tuaj për më tepër qetësi mendore gjatë udhëtimit

Shërbimet që ofrohen nga asistenca rrugore



**Qendra e
kontaktit 24/7**



**Riparim
në vend**



Karroatrec



Parkim



**Zëvendësim i
automjetit në
rast aksidenti***



**Akomodimi
në hotel***



**Riatdhesim me tren
/avion ose udhëtim
drejt mbërritjes***



Taxi

Shënim

Opsionet e shënuar me *, klienti mund të përzgjedhë
vetëm njërin prej këtyre shërbimeve: zëvendësim të mjetit
ose akomodim në hotel ose vazhdim të udhëtimit.

 **068 606 2829**



VAS
GROUP
Global Travel Company

Vas Tour

DMC - EUROPE
Vienna, Austria
www.travelvas.com

Vas Tour

DMC - BOSNIA & HERZEGOVINA
Sarajevo, Bosnia & Herzegovina
www.vas.ba

Albtours D

DMC - BALKAN
Tirana, Albania
www.albtoursd.com

Vas Tour

DMC - TURKEY
Antalya, Turkey
www.vas-tour.com

Vas Tour

DMC - GCC
Dubai, UAE
www.vastour.ae

Vas Group is composed of different businesses operating in the travel industry, each of these working to be an outstanding brand in the respective markets.

For years the company has been inspiring the travel community bringing the most distant destinations at clients reach, discovering the hidden treasures of each place, feeling the beat of ancient worlds, creating amazing memories.

Vas group is always engaged to be updated with travel innovations and coming up with several services which have widen the solutions for our business partners.

www.vasgroup.net



18 nëntor 2014 ITALI-SHQIPËRI

1-0

Golat: (1-0) Stefano Okaka 82'

Gjyqtar: Ovidiu Hategan

Stadiumi: "Luigi Ferraris", Genoa - Pjesëmarrja: 26 000 spektatorë

Italia: Salvatore Sirigu (Mattia Perin 73'), Luca Antonelli, Leonardo Bonucci (Francesco Acerbi 82'), Lorenzo De Silvestri, Emiliano Moretti, Alberto Aquilani, Andrea Bertolacci (Giacomo Bonaventura 70'), Marco Parolo, Alessio Cerci (Manolo Gabbiadini 77'), Mattia Destro (Alessandro Matri 64'), Sebastian Giovinco (Stefano Okaka 65')

Trajner: Antonio Conte

Shqipëria: Etrit Berisha, Lorik Cana (c), Andi Lila (Valdet Rama 90'), Mërgim Mavraj, Ansi Agolli, Elseid Hysaj (Arlind Ajeti 74'), Amir Abrashi (Herolind Shala 71'), Sokol Cikalleshi (Hamdi Salihi 78'), Burim Kukeli (Odise Roshi 67'), Ermir Lenjani (Bekim Balaj 86'), Ledian Memushaj

Trajner: Gianni De Biasi

24 mars 2017 ITALI-SHQIPËRI

2-0

Golat: (2-0) Daniele De Rossi 12', (2-0) Ciro Immobile 71'

Stadiumi: Renzo Barbera, Palermo - Pjesëmarrja: 33136 spektatorë

Italia: Gianluigi Buffon, Andrea Barzagli, Leonardo Bonucci, Mattia De Sciglio, Davide Zappacosta, Antonio Candreva, Daniele De Rossi, Marco Verratti, Andrea Belotti, Ciro Immobile, Lorenzo Insigne

Trajner: Gian Piero Ventura

Shqipëria: Thomas Strakosha, Arlind Ajeti, Andi Lila (Armando Sadiku 67'), Frëddie Veseli, Ansi Agolli, Elseid Hysaj, Migjen Basha (Liridon Latifi 87'), Sokol Cikalleshi, Burim Kukeli, Ledian Memushaj, Odise Roshi (Eros Grezda 78')

Trajner: Gianni De Biasi

9 tetor 2017 ITALI-SHQIPËRI

0-1

Golat: (0-1) Antonio Candreva 73'

Gjyqtar: Svein Oddvar Moen

Stadiumi: "Loro Boriç i", Shkodër - Pjesëmarrja: 14718 spektatorë

Shqipëria: Etrit Berisha, Mërgim Mavraj, Frëddie Veseli, Ansi Agolli, Elseid Hysaj, Migjen Basha (Andi Lila 68'), Eros Grezda, Ergys Kaçe, Ledian Memushaj (Liridon Latifi 76'), Odise Roshi (Valon Ahmedi 90'), Armando Sadiku

Trajner: Christian Panucci

Italia: Gianluigi Buffon, Leonardo Bonucci, Giorgio Chiellini, Matteo Darmian (Davide Zappacosta 61'), Leonardo Spinazzola, Antonio Candreva, Roberto Gagliardini, Marco Parolo, Éder (Manolo Gabbiadini 89'), Ciro Immobile, Lorenzo Insigne (Stephan El Shaarawy 90')

Trajner: Gian Piero Ventura



Kampionatit Botëror 'Rusi 2018'. Edhe këto janë dy ndeshje të fituara nga 'axurrët', sërisht me rezultate minimale. Sfidat e parë u luajt në Itali, në stadiumin 'Renzo Barbera' në Palermo, më 24 mars 2017. Ital-

ianët fituan me rezultatin 2-0, me golat e shënuar nga Daniele De Rossi, me penallti në minutën e 12-të dhe Ciro Immobile në minutën e 71-të. Mbahet mend edhe në këtë ndeshje, atmosfera e zjarrtë që krijuan tifozët kuqezi, të cilët ishin me qindra e mijëra në stadiumin prej rreth 34 mijë vendesh në Palermo.

Ndeshja tjetër e vlefshme për këto kualifikuese u luajt në Shqipëri, më 8 tetor të vitit 2017. Tifozët shqiptarë 'pushtuan' stadiumin 'Loro Boriç i', pasi për herë të parë, ekipi i axurrëve vinte të luante në Shqipëri. Biletat përfunduan kur kishin mbetur më tepër se 72 orë nga nisja e ndeshjes, me kërkesën rekord të tifozëve, që edhe pse ëndërronin një fitore kundër Italisë, sërisht nuk u zhgënjyen nga Kombëtarja. Fundja, kuqezinjtë kishin përballë katër herë kampionët e Botës. Goli i shënuar nga Antonio Candreva në minutën e 73-të vendosi fatin e këtij takimi, teksa kjo ndeshje mbahet mend edhe për ceremoninë e lamtumirës së kapitenit legjendar, Lorik Cana. Ai përshëndeti të gjithë tifozët kuqezi përpara ndeshjes, teksa mori duartrokitjet e të gjithëve.

HISTORIKU I PËRBALLJEVE SHQIPËRI - ITALI

Kombëtarja shqiptare do të presë Italinë mbrëmjen e 16 nëntorit në stadiumin 'Air Albania', një ndeshje që më shumë sesa miqësore, është një përballje prestigji për kuqezinjtë. Kampionët e Europës do të zbresin për herë të parë në stadiumin 'Air Albania' të Tiranës, teksa kjo është hera e dytë që axurrët udhëtojnë drejt Shqipërisë.

Shqipëria dhe Italia kanë luajtur me njëra-tjetrën katër herë në total, ndër të cilat vetëm 2 kanë qenë në kuadër të kualifikueseve të Kampionatit Botëror 'Rusi 2018'. Edhe pse dy shtetet janë shumë afër me njëra-tjetrën dhe ndër të tjera, lidhja Shqipëri-Itali është shumë e fortë edhe për shkak të shumë shqiptarëve që jetojnë në vendin fqinj, takimi i parë mes këtyre dy përfaqësuesve daton më 18 nëntor 2014.

Kjo sfidë historike është zhvilluar në Itali, iniciativë e Federatës Italiane të Futbollit për të ndihmuar të përmbyturit në qytetin e Genoa-s, ku edhe u

zhvillua ndeshja. Në stadiumin 'Luigi Ferraris', që ka një kapacitet prej 26 mijë tifozësh, më shumë se gjysma ishin shqiptarë, emocionet e të cilëve ishin të mëdha. Kuqezinjtë u mundën me rezultatin minimal 1-0, me një gol të realizuar nga Stefano Okaka në minutën e 82-të të takimit.

Shqipëria drejtohej asokohe nga trajneri Gianni De Biasi, i cili kishte hedhur në fushë 11-shen e tij më të mirë: Etrit Berisha, Lorik Cana (c), Andi Lila, Mërgim Mavraj, Ansi Agolli, Elseid Hysaj, Amir Abrashi, Sokol Cikalleshi, Burim Kukeli, Ermir Lenjani, Ledian Memushaj. Një ndeshje vërtetë elektrizuese, që mbahet mend ende sot e kësaj dite, sidomos për koret kuqezi që nuk pushuan gjatë gjithë lojës. Ra në sy një nga banderolat e shpalosura nga tifozët tanë, ku shkruhej: 'Siamo venuti col gommone, adesso abbiamo il squadrone', që në shqip përkthet: Kemi ardhur me gomone dhe tani kemi një skuadër. Dy takimet e radhës ishin ato për eliminatoret e

ENJOY THE ZENITH EXPERIENCE

ZYRTARËT E NDESHJES SHQIPËRI-ITALI

ROLI	EMRI	KOMBËSIA
Referee:	Genc Nuza	
1st Assistant :	Fatlum Berish	
2nd Assistant :	Bujar SelimaJ	
Fourth official :	Juxhin Xhaja	

Vodafone GigaNet

Rrjeti më i mirë celular dhe fiks
në Shqipëri. I vetmi i certifikuar
nga Umlaut për vitin 2022.



Celular



Internet Fiks



TV

Ti mund të përjetosh gjithçka
në një rrjet që nuk njeh limite

Together we can

